



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË
PËRGJITHSHËM
KORÇË

RAPORT ANALIZA VJETORE VITI GJYQESOR 2024





REPUBLIKA E SHQIPËRIË

GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM KORÇË

ANALIZA

E GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM KORÇË

PËR VITIN GJYQËSOR 2024

HYRJJE

Kjo analizë ka si objekt të saj, punën njëvjeçare të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë për vitin 2024, e cila përfshin komponentët kryesorë të veprimtarisë së gjykatës sikurse janë: cilësia e gjykimeve, shpejtësia e gjykimeve, profesionalizmi, etika profesionale, sasia në tërësi e çështjeve të gjykuara nga kjo gjykatë, puna e administratës gjyqësore si dhe shërbimet e ofruara për publikun.

Në mënyrë të detajuar ajo përmban të gjitha aspektet e punës, të pasqyruara në të dhënat përkatëse të cilat, japin informacion për rezultatet e arritura si dhe mundësinë për të synuar objektiva më të larta për vitin 2025.

Nëpërmjet kësaj analize synohet një gjithpërfshirje e rezultateve të punës së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, por edhe një vlerësim për arritjet e realizuara në mënyrë që objektivat për të ardhmen të jenë më të mira dhe të bazuara në rezultate me profesionalizëm më të lartë.

Parametrat e punës në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë për vitin 2024, të marra në kompleks tregojnë qartazi për një rritje të pothuaj gjithë treguesve, të cilët përbëjnë njëherazi standartet e një gjykimi eficient dhe objektiv.

Padyshim që arritja e këtyre parametrave tregon për një punë serioze dhe profesionale të gjithë trupës gjyqësore dhe administratës gjyqësore, si dhe të shërbimeve ndihmëse të kësaj gjykate.

Megjithatë duhet theksuar fakti që gjatë këtij viti, të gjithë punonjësit e gjykatës kanë hasur edhe vështirësi, duke bërë përpjekje maksimale për evitimin e tyre.

Në vijim po paraqesim një tablo të hollësishme të treguesve të punës si dhe të problematikës së konstatuar gjatë vitit 2024.

1. NGARKESA NË PUNË DHE ORGANIZIMI I SAJ

Me vendimin nr. 87 Prot datë 31.03.2023 të Këshillit të Gjykatës “Për miratimin e strukturës, organikës dhe përshkrimet e punës të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë”, është miratuar organika e institucionit e cila përbëhet nga 63 punonjës.

Sipas organikës numri i gjyqtarëve është 15.

- Administrimi i gjykatës është kryer nga kancelari i gjykatës i cili është kujdesur për menaxhimin me efikasitet të burimeve njerëzore. Kancelari ka mbikëqyrur procesin e organizimit dhe të dokumentimit të shortit elektronik për ndarjen e çështjeve gjyqësore. Ka bashkërenduar me kryesekretarinë për përcjelljen në kohë të vendimeve gjyqësore të formës së prerë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Korçë, me qëllim ekzekutimin e tyre. Ka përgatitur dhe raportuar në kohë materialet statistikore në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe ILD-në dhe Ministrinë e Drejtësisë. Kancelari në bashkëpunim me kryesekretarinë kanë kryer pritjen dhe sqarimin e popullit gjatë gjithë orarit zyrtar, duke shërbyer në kohë me përgjegjësi të lartë.

Në përbërjen e saj gjykata ka 4 sektorë të cilët koordinojnë punën midis tyre dhe mbikëqyren nga kancelari i gjykatës. Ndërmjet sektorëve zhvillohen takime të përditshme lidhur me problematikat e dala gjatë ditës. Kryesekretaria ka përcjellë në kohë dosjet gjyqësore pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, por edhe në gjykata të tjera sipas disponimeve të gjykatës. Sekretaria gjyqësore ka regjistruar në kohë çështjet gjyqësore dhe numëruar vendimet përkatëse por dhe ka hapur fashikujt e gjykimeve.

Sektori i Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar

Buxheti i administruar bashkë me ndryshimet nga institucioni qendror (KLGJ) për vitin 2024 në total është 157,140,000 lek dhe realizimi i tij është 156,512,791 lekë dhe në % realizimi është në masën është 97.12 %, i detajuar si më poshtë:

			Plani vjetor	Fakti vjetor	% realiz	diferenca
000 lek						
1-Investime	artik 231		2,400	2,300	95.8 %	- 100
2-Paga	artik 600		118,200	118,028	100 %	- 172
3-Sig shoq	artik 601		14,650	13,578	92.7 %	- 1072
4-Shpenz operati	602		21,890	21,849	99.8%	- 41
5-Shpenz	606		763	758	99.3%	- 5

I-Investimet janë realizuar 95.8%

II-Pagat janë realizuar 100 %, duke përfshirë këtu dhe likuidimet e diferencës së gjyqtarëve sipas vendimit të Gjykatës Kushtetuese, për diferencën e mbetur për periudhën Shtator 2021 deri 8 Janar 2023.

III-Sigurimet shoqërore realizimi është 92.7%.

IV-Shpenzimet operative janë realizuar 99.8%.

Të gjitha zërat e shpenzimeve janë realizuar, duke përdorur me efikasitet të gjitha fondet e alokuara për vitin 2024.

V-Shpenzime nga të ardhurat e institucionit.

Gjatë vitit 2024 nga institucioni janë realizuar 5.646.334 Lek të ardhura, nga të cilat sipas legjislacionit në fuqi pjesa takuese e institucionit është 557.652 lekë. Nga të ardhurat (pjesa që i takon institucionit) u përdorën përdorën 420.000 Lek për shpenzime operative të detajuara: 350.000 lekë për blerje kuti arkivi për ruajtje të përhershme dhe 69.000 lek shpenzime për avokat të caktuar kryesisht. Të ardhurat u realizuan 75.3%.

Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse

Në kuadër të detyrave funksionale, sektori ka realizuar aktivitetin e tij si më poshtë:

1-Në lidhje me burimet njerëzore, në mbështetje të Vendimit të KLGJ-së nr.150 datë 29.03.2023, në të cilin përcaktohen detyrat kryesore funksionale të këtij sektori, janë realizuar këto detyra:

a-Ka administruar dhe përmirësuar Regjistrin e Personelit të Gjykatës si dhe janë verifikuar dosjet ekzistuese të personelit, janë krijuar dosjet e reja për atë pjesë të personelit që është rekrutuar gjatë vitit 2024. Regjistri themeltar dhe dosjet e personelit janë krijuar dhe përmirësuar konform kërkesave të VKM-së nr.833 datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurë dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”.

b-Ka ndihmuar kancelaren për hartimin e përshkrimeve të punës.

c-Ka ndihmuar kancelaren në procesin e rekrutimit të punonjësve të gjykatës duke përgatitur dokumentat dhe aktet e nevojshme për realizimin e këtij procesi.

d-Është kujdesur për plotësimin e stafit me bazën materiale për një funksionim normal të aktivitetit të gjykatës, duke bërë verifikimin e gjendjes së këtyre materialeve dhe mbi këtë bazë ka realizuar prokurimet publike dhe ka nxjerrë urdhërat e shpërndarjes sipas kërkesave të personelit.

e-Ka bërë verifikimin periodik të situatës së automjeteve, elementeve të sigurisë, të njoftimeve nga ana e nëpunësve gjyqësore, nivelin e mirëmbajtjes në përgjithësi si dhe situatës së nivelit të gjendjes higjeno-sanitare.

Gjatë vitit 2024 janë shpallur 16 procedura rekrutimi për 7 pozicione pune nga të cilat 4 procedura kanë përfunduar me kandidatë fitues, ndërsa 3 procedura kanë përfunduar pa kandidatë fitues. Nga këto janë përfunduar procedurat me kandidatë fitues për pozicionet si më poshtë:

-Shef i Sektorit të Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar

-Specialist Finance

-Specialist Buxheti

-Shef i Sektorit IT, Statistikat, Marrëdhëniet me Publikun dhe Median

2-Në lidhje me prokurimet publike sektori ka realizuar aktivitetin e tij si me poshtë:

a-Ka realizuar prokurimet publike sipas regjistrit të parashikimit të prokurimeve publike në bashkëpunim të ngushtë edhe me sektorin e buxhetit dhe menaxhimit financiar dhe kur është parë e arsyeshme është bërë edhe ndryshimi në disa elemente të regjistrit sipas vlerësimit të nevojave të reja të institucionit.

b-Sektori ka zbatuar me përpikmëri legjislacionin në fushën e prokurimeve publike.

Janë realizuar 25 procedura prokurimi me objekte dhe fond limit si më poshtë:

Nr	Objekti i prokurimit	Fondi limit me tvsh	Monedha
1	Mirëmbajtje ashensori	400,000	Lekë
2	Shtypshkrime	200,000	Lekë
3	Letër për printera e fotokopje	435,000	Lekë
4	Tonera për printera e fotokopje	319,000	Lekë
5	Materiale pastrimi	199,000	Lekë
6	Lëndë djegëse druri (Pelet)	320,000	Lekë
7	Karburant për automjete e gjenerator	645,000	Lekë
8	Kancelari	193,000	Lekë
9	Materiale pastrimi	53,400	Lekë
10	Tonera për printera e fotokopje	317,000	Lekë
11	Hidroizolim tarrace	2,400,000	Lekë
12	Lëndë djegëse druri (Pelet)	946,000	Lekë
13	Sistemim dhe mirëmbajtje e ambienteve të hyrjes të publikut dhe sallave të gjyqit	500,000	Lekë
14	Tonera për printera e fotokopje	340,000	Lekë
15	Kancelari	155,000	Lekë
16	Letër për printera e fotokopje	210,000	Lekë
17	Shtypshkrime	64,000	Lekë
18	Shërbim periodik i automjetit	40,000	Lekë

19	Mirëmbajtje gjeneratori	120,000	Lekë
20	Materiale teknike	58,000	Lekë
21	Materiale elektrike	62,000	Lekë
22	Mirëmbajtje mjete transporti	35,000	Lekë
23	Larje automjeti	50,000	Lekë
24	Mbushje, kolaudim fikse zjarri	65,000	Lekë
25	Mirëmbajtje pajisje elektronike	98,000	Lekë
Shuma		8,224,400	Lekë

Sektori i IT, Statistikës dhe Marrëdhënieve me Publikun dhe Median

Sektori i IT, Statistikës dhe Marrëdhënieve me Publikun dhe Median përbehet nga:

- Shefi i Sektorit
- Specialisti IT-së
- Specialisti i Marrëdhënieve me Publikun dhe Median (ZMP)

Ky sektor ka kryer të gjitha detyrat funksionale sipas nenit 12 të Vendimit Nr. 150, datë 29.03.2023 “Për miratimin e rregullave standarte për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësi të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë të gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, kategoria e dytë dhe e tretë me zyra shërbimi”, si dhe rregulloreve të përgjithshme dhe të veçanta të gjykatës.

Përgjatë vitit 2024, sektori ka kryer një sërë mirëmbajtjesh proaktive në infrastrukturën IT, duke përfshirë sistemet operative, aplikacionet, bazat e të dhënave, serverat, sistemet e postës elektronike si dhe pajisjet si laptopët, desktopët, softuerin dhe harduerin. Gjatë vitit janë implementuar azhurnime dhe përmirësime, duke instaluar patch-e sigurie dhe duke testuar performancën e sistemeve për të garantuar funksionimin optimal. Përveç kësaj, IT-ja ka ofruar asistencë të menjëhershme ndaj administratës në rastet kur kanë lindur problematika teknike, duke u siguruar që këto të minimizohen në kohë rekord.

Sektori ka bashkëpunuar ngushtë me KLGJ-në dhe kompanitë përkatëse që ofrojnë shërbime për sistemin ICMIS dhe sistemin audio RDA. Konkretisht, për vitin 2024 janë kryer 17 kërkesa për suport teknik pranë KREATX SHPK dhe 2 kërkesa pranë FORSITEK SHPK, të cilat kanë konsistuar kryesisht në detaje teknike të dala rishtazi.

Infrastruktura ekzistuese IT ka demonstruar aftësi për të përballuar rritjen e trafikut dhe ka pasur kapacitetin e duhur për nevojat aktuale të gjykatës, por në të ardhmen do të nevojiten investime të vazhdueshme për tu përshtatur me zhvillimet teknologjike si dhe ngarkesën e shërbimeve që ofron gjykata. Kështu, janë paraqitur pranë KLGJ-së nevojat për përmirësime, të cilat janë përfshirë në PBA 2025-2027. Gjatë vitit 2024 ka vijuar modernizimi i pajisjeve elektronike, duke përfshirë ndryshimin e mikserëve audio, kompjuterëve, ekraneve, mikrofonëve, baterive UPS dhe printerave. Një pjesë e madhe e stafit të gjykatës është pajisur me infrastrukturë të re, duke u siguruar që proceset administrative të zhvillohen me efikasitet maksimal.

Siguria e të dhënave gjyqësore ka qenë një prioritet kyç i sektorit. Analiza e riskut ka treguar se nuk ka patur shkelje të sigurisë apo humbje të të dhënave gjatë vitit 2024. Janë zbatuar politikat e duhura për të garantuar integritetin dhe privatësinë e të dhënave, ndërsa backup-et janë kryer sipas planifikimeve të parashikuara. Të gjitha kompjuterët dhe serverat e institucionit janë përfshirë në politikën mbrojtëse të domain-it të gjykatës, dhe për më shumë siguri, janë instaluar agjentët Trellix për mbrojtje nga rreziqet kibernetike.

Sektori ka pasur rol thelbësor në përpunimin e të dhënave të mbledhura statistikore, në koordinim me sektorët e tjerë të gjykatës si Sektori i Protokollit, Arkivës dhe i Koordinimit të Zyrave të Shërbimit si dhe Kryesekretarinë. Gjatë vitit 2024, janë përgatitur raporte të detajuara statistikore për ecurinë e çështjeve të trajtuara dhe efikasitetin e gjykatës. Statistikat periodike janë dërguar rregullisht pranë KLGJ-së si dhe Ministrisë së Drejtësisë, Digjitalizimi i proceseve statistikore me qëllim automatizimin sa më të saktë të të dhënave ka qenë në fokus të këtij sektori.

Gjatë vitit 2024, në drejtim të rritjes të transparencës dhe aksesit në drejtësi, ka vijuar aksesit nëpërmjet pajisjes “Infopoint” të vendosur në hollin e gjykatës. Nëpërmjet pajisjes “Infopoint” publiku, avokatët, përfaqësuesit ose palët kanë mundësi të marrin informacion mbi shortin, si dhe informacione mbi çështjen ku është palë ndërgjyqëse në kohë reale nga faqja zyrtare e internetit të gjykatës ose sistemi i gjykatës pa patur nevojë të pyesin apo të presin në rradhë tek zyra e informacionit.

Në përputhje me nenin 7 të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” është përgatitur, programi i transparencës për Gjykatën e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë. Programi i transparencës është publikuar dhe përditësuar në faqen zyrtare të gjykatës. Gjykata ka marrë të gjitha masat për respektimin maksimal të të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga ky ligj, duke publikuar në faqen e saj elektronike zyrtare informacionin dhe dokumentacionin e disponuar prej saj, të parashikuar nga ligji, për publikim kryesisht nga autoriteti publik.

Specialisti për Marrëdhëniet me Publikun, Median dhe me Jashtë ka informuar në kohë publikun mbi veprimtarinë e gjykatës dhe menaxhimin e komunikimit me median. Për vitin 2024 rezultojnë të regjistruara gjithsej 37 kërkesa në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve, duke specifikuar se janë regjistruar ato kërkesa që kanë ardhur në respektim të nenit 11, të Ligjit Nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” duke u përmbajtur afateve ligjore të kthimit të përgjigjes. ZMP në bashkëpunim dhe me gjyqtarin e medias ka përgatitur deklaratat zyrtare për median për çështje me interes publik cdo herë sipas rastit. Gjithashtu, janë monitoruar dhe analizuar publikimet në media, lidhur me aktivitetin e gjykatës, për të adresuar informacione të pasakta. Faqja zyrtare e gjykatës në domainin gjykata.gov.al dhe rrjetet sociale ku gjykata është prezent janë përditësuar rregullisht për të siguruar transparencë dhe qasje sa më të lehtë për qytetarët. Në raport me median gjykata ka treguar bashkëpunim të vazhdueshëm, i cili rezulton se ka qenë në nivelin e duhur, duke komunikuar sipas rastit në lidhje me informacione apo seanca gjyqësore për të cilat publiku ka patur interes. Në këto raste media apo gazetarët personalisht janë informuar me anë të njoftimeve elektronike, grupit të WhatsApp në kohë.

Sektori i Koordinimit të Zyrave të Shërbimit dhe Protokoll/Arkiva

Sektori i Koordinimit të Zyrave të Shërbimit dhe Protokoll/Arkiva përbëhet nga shefi i sektorit, 1 specialist i arkiv/ protokollit dhe 1 specialist i zyrës së shërbimit Pogradec. Në

zbatim të ligjit 9154 datë 06.11.2003 “Për arkivat”, i ndryshuar dhe Vendimit nr 4 datë 19.06.2017 të Këshillit të Lartë të Arkivave janë përmbushur me rigorozitet detyrat e caktuara:

- Përpilimi i urdhërit për njehsimin e dokumentit administrativ
- Ngritja e Komisionit të Ekspertizës
- Lista konkrete me afatet e ruajtjes
- Pasqyra emërtuese e çeljes së dosjeve
- Përpunimi i dokumentacionit administrativ i vitit 1999-2000

Gjithashtu mbështetur në Ligjin Nr.9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, i ndryshuar si dhe bazuar në Vendimin e KLGJ-së Nr. 426, datë 14.10.2022 si dhe në Rregulloren nr. 202 datë 15.05.2023 të ASHSGJ-së është realizuar me sukses procesi i asgjësimit të dosjeve gjyqësore të Rrethit Gjyqësor Korçë me ruajtje të përkohshme nga viti 1961-1964 me numër total 1135 dosje të konfirmuara dhe me Vendimin nr 8 datë 20.12.2024 të KEESGJ. Përgjatë vitit 2024 janë përpunuar edhe dosjet me ruajtje të përhershme të ish Gjykatës Pogradec nga viti 1993-2000 të përcjella prane Arkivit Shtetëror të Sistemit Gjyqësor Lundër, Tiranë dhe të miratuara prej tyre. Përgjatë vitit nga ana e këtij sektori është realizuar përgatitja e kodekseve gjyqësore për vitin 2023. Marrja në dorëzim e dosjeve gjyqësore të vitit 2023 nga kryesekretaria dhe administrimi i tyre në ambientet e arkivës. Dosjet gjyqësore të ardhura nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë apo Gjykata e Lartë Tiranë janë të nënshkruara dhe të marra në dorëzim nga specialistja e arkivës duke u sistemuar pranë ambientit të arkivës.

Është realizuar në mënyrë të rregullt mbajtja e librit të korrespondencës me urdhërat e brendshëm dhe të jashtëm sipas dispozitave ligjore dhe normative në fuqi.

Specialistja e arkivës pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë ka komunikuar brenda afateve të lejuara të gjitha vendimet gjyqësore, aktet noteriale apo akte të tjera të ndodhura në dosjet gjyqësore sipas kërkesave të qytetarëve. Libri i shkresave postare është mbajtur në menyrë të rregullt sipas numrave rendorë dhe shpërndarë në kohë reale tek gjyqtarët, kancelarja apo sektorëve që ju përkasin duke marrë dhe nënshkrimet e tyre tek libri i dorëzimit të shkresave postare. Çdo kërkesë e erdhur me postë apo në mënyrë elektronike që i përket sektorit tonë është realizuar me sukses brenda afateve duke dhënë informacionin e duhur.

Përgjatë këtij viti specialistja e arkivës është përgjigjur çdo kërkesë nga ana e gjyqtarëve për aktet apo dosjet që ata kanë kërkuar për nevoja gjykimi duke mos penguar proceset gjyqësore

- Gjatë këtij viti janë mbajtur kontakte të rregullta me zyrën e shërbimit Pogradec duke i orientuar në lidhje me vijueshmërinë e punëve pranë kësaj zyre.

- Përgjatë vitit 2024 specialistja e zyrës të shërbimit Pogradec ka trajtuar me korrektësi dhe përpikmëri kërkesat e paraqitura nga qytetarë të ndryshëm duke komunikuar brenda afateve vendimet gjyqësore, vërtetimet dhe çdo informacion shtesë të kërkuar.

Theksojmë se sektori ka përmbushur me sukses të gjitha detyrat duke u koordinuar për arritjen e qëllimeve të njëjta duke realizuar një proces pune të suksesshëm.

INFORMACION NË LIDHJE ME TRUPËN GJYQËSORE TË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM KORÇË

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë ka në organikën e saj 15 gjyqtarë, por në fakt deri në muajin Maj 2024, funksionin e gjyqtarit pranë kësaj gjykate e ushtronin 12 gjyqtarë. Me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor gjyqtarët Artan Jahollari, Sonjela Voskopi dhe Ervin Sulaj, në bazë të kërkesës të tyre u transferuan në gjykata të tjera. Pranë gjykatës me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor u caktuan gjyqtarët Vajlona Haxhiraj, Eda Diko, Dorinela Nikolli dhe gjyqtar Suzan Bushi, të cilëve iu kaluan për gjykim dosjet gjyqësore të gjyqtarëve të transferuar.

Referuar të dhënave statistikore ngarkesa e gjyqtarëve është si më poshtë:

Nr.	Gjyqtari	Nr. çështjeve të mbartura nga vitet e mëparshme¹	Nr. çështjeve të regjistruara të reja (nga data 01 janar- 30 Dhjetor)²	Nr. çështjeve të gjykuara (Janar-Dhjetor)³	Nr. Çështjeve në shqyrtim⁴
1.	Artan Jahollari	156	143	295	4
2.	Ervin Sulaj	120	212	309	23
3.	Ervin Kore	113	427	398	142
4.	Eglantina Mikani	327	378	448	257
5.	Estjon Venxha	108	440	424	124
6.	Elena Tafa	63	74	137	0
7.	Klajdi Tërova	86	411	393	104
8.	Luljeta Kole	208	450	445	213
9.	Luljeta Kolonja	351	412	442	321
10.	Seladin Pysqyli	99	166	265	0
11.	Sonjela Voskopi	72	194	264	2
12.	Gentiana Shukullari	218	448	463	203
13.	Thomaidha Roça	4	0	3	1
14.	Dorinela Nikolli	58	178	112	124
15.	Suzan Bushi	66	174	76	164
16.	Valjona Haxhiraj*	62	159	61	160
17.	Eda Diko*	55	192	76	171
TOTALI		2166	4458	4611	2013

¹ Kjo e dhënë kërket vetëm në raportimin e parë tremujor të çdo viti.

² Numri aktual i çështjeve të reja të regjistruara që nga fillimi i vitit, (jo vetëm për tremujorin raportues)

³ Çështje të gjykuara që nga fillimi i vitit deri në datën e raportimit (jo vetëm për tremujorin e raportimit)

⁴ Numri i çështjeve në shqyrtim në momentin e raportimit

Po ashtu, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë funksionon seksioni penal për të mitur për gjykimin e çështjeve penale me të mitur në konflikt me ligjin ose të mitur viktimë nga vepra penale.

Në zbatim të Udhëzimit nr. 79, datë 30.05.2019, “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve të drejtësisë për të mitur” të Këshillit të Lartë Gjyqësor, me Urdhërin Nr. 23, datë 16.09.2024, të Këshillit të Gjykatës, janë caktuar gjyqtarët Luljeta Kolonja, Klajdi Tërova dhe Estjon Venxha, gjyqtarë për çështjet penale me të mitur.

Ndarja e çështjeve si civile dhe ato penale gjatë vitit 2024 është bërë çdo ditë, në mënyrë periodike, të shpejtë dhe transparente, me anë të sistemit elektronik të shortit, të implementuar zyrtarisht në gjykatë, duke dokumentuar për çdo rast me procesverbal çdo ndërhyrje për shkaqe teknike dhe objektive në këtë sistem, si përjashtime apo dorëheqje të gjyqtarëve, sqarime apo interpretime vendimi etj.

Në këtë gjykatë është aplikuar sistemi audio rekorder i mbajtjes së seancave gjyqësore për të gjithë gjykimet, me përjashtim të kërkesave me karakter sekret apo ato çështje për të cilat ligji përcakton se zhvillohen nga gjyqtari në dhomë këshillimi.

Po kështu, në Gjykatë është implementuar prej vitesh dhe ka funksionuar normalisht kalendari elektronik i planifikimit të seancave gjyqësore (PAKS), çka eviton përplasjet në përdorimin e sallave të gjykimit.

2. NGARKESA DHE LLOJI I ÇËSHTJEVE GJYQËSORE

Gjatë vitit 2024 në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë kanë qenë për shqyrtim në total **6624** çështje (të natyrës penale, penale-administrative, civile dhe familjare), ku përfshihen 2166 çështje të mbartura nga viti 2023 dhe 4458 çështje të regjistruara të reja në vitin 2024. Me vendimin nr. 134 datë 28.03.2023 “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë”, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec ndërpret veprimtarinë në datë 30.04.2023.

Nga totali i çështjeve për shqyrtim, vetëm për **4611** çështje është përfunduar gjykimi në vitin 2024, ndërsa 2013 çështje janë mbartur për gjykim në vitin 2025, sipas tabelës 1.

Tabela.1

Volumi i Çështjeve viti 2024	Numri
Çështje të gjykuara	4611
Çështje të regjistruara + çështje të mbartura	6624
Çështje të mbartura në vitin 2025	2013

Nga totali i çështjeve të gjykuara rezulton se:

- ❖ **Në lëndë penale** janë gjykuar në total 2811 çështje, ku përfshihen çështje penale themeli, kërkesa penale-administrative, kërkesa penale gjatë hetimeve paraprake, në seancë paraprake dhe kërkesa penale gjatë fazës së ekzekutimit të dënimit.
- ❖ **Në lëndë civile**, janë gjykuar në total 1800 çështje, ku përfshihen çështje civile themeli, lëshim urdhër i menjëhershëm mbrojtjeje, lëshim urdhër ekzekutimi, kërkesa civile-administrative.

Nga analiza e të dhënave të mësipërme, rezulton se ngarkesa me çështje gjyqësore është e lartë për numrin e gjyqtarëve të gjykatës.

Në vitin 2024, numri i çështjeve penale dhe civile të gjykuara rezulton më i ulët se në vitin 2023 me një diferencë prej 80 çështje më pak të gjykuara se në vitin 2023. Përgjatë vitit 2023 kanë përfunduar gjykimin 4691 çështje ndërsa në vitin 2024 janë gjykuar 4611 çështje. Krahasuar me një vit më parë janë gjykuar 80 çështje gjyqësore më pak se në vitin 2023.

Përgjatë vitit 2024, vihet re një rënie e çështjeve civile të reja të paraqitura në gjykatë, konkretisht 458 çështje civile më pak të depozituara gjatë vitit. Diferenca ndërmjet çështjeve të depozituara dhe çështjeve të përfunduara është me e ulët gjatë vitit 2024, referuar treguesve statistikorë, kjo ka ndodhur dhe për shkak të transferimit të gjyqtarëve. Për sa i përket çështjeve penale përgjatë vitit 2024, vihet re një ulje e lehtë e kërkesave të depozituara konkretisht 3 çështje penale më pak të depozituara se gjatë vitit 2023. Gjatë vitit 2024, janë gjykuar me trup gjykues 7 çështje gjyqësore civile.

3. TENDENCA E NGARKESËS ME ÇËSHTJE

Të dhënat statistikore për volumin e çështjeve tregojnë se në vitin 2024 krahasuar me vitin 2023 ka një rritje të numrit të çështjeve penale të gjykuara me 128 çështje më shumë të gjykuara, krahasuar kjo me një vit më parë.

Nga ana tjetër vihet re rënie në numrin e çështjeve civile të gjykuara konkretisht 208 çështje gjyqësore më pak të gjykuara, kjo për shkak të plotësimit të gjyqtarëve me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor pasi një pjesë e të cilëve janë larguar nga procesi i vetingut, si dhe marrja pjesë në skemë delegimi i gjyqtarëve, apo dhe transferimi i tyre si dhe kompleksiteti i çështjeve gjyqësore civile, si dhe ankimet ndaj vendimeve të ndërmjetme. Ngarkesa vijon të mbetet e lartë për numrin e gjyqtarëve në organikën e gjykatës.

Raporti i numrit të çështjeve të regjistruara në dy vitet e fundit gjen pasqyrim në tabela 2.

Tabela.2

	Çështje të regjistruara	Çështje të gjykuara	Çështje të mbartura
Viti 2024	6624 2166 të mbartura + 4458 të rregjistruara të reja nga data 01.01.2024- 31.12.2024	4611	2013
Viti 2023	6857 1938 të mbartura + 4919 të rregjistruara të reja nga data 01.01.2023- 31.12.2023	4691	2166

4. LIKUIDIMI/ PËRFUNDIMI I ÇËSHTJEVE

Raporti i numrit të çështjeve të mbartura në vitin 2025:

Tabela.3

Lloji i çështjeve të mbartura	Numri
Penale themeli.	288
Kërkesa gjatë hetimeve paraprake, kërkesa të veçanta penale, kërkesa në fazën e ekzekutimit etj	641
Civile themeli	1008
Kërkesa civile	176

I. Norma e zgjidhjes/ likuidimit të çështjeve (*Clearance rate*) në vitin 2024 (që është raporti i thjeshtë i dalë nga pjestimi ndërmjet çështjeve të zgjidhura me çështjet e reja të regjistruara brenda një periudhe vjetore, i shprehur në përqindje) është **103%**.

Norma e zgjidhjes së çështjeve tregon se gjykata ka qenë e aftë të zgjidhë më shumë çështje se sa janë regjistruar për shqyrtim në vitin 2024 dhe për rrjedhim janë zgjidhur edhe një pjesë e çështjeve të mbartura nga viti 2023.

Duke patur parasysh edhe ngarkesën shumë të lartë me çështje të regjistruara të reja në vitin 2024, përkatësisht **(në total për 12 gjyqtarë)**, del se ky tregues është pozitiv.

Në total:

4611 [numri i çështjeve të gjykuara]

Clearance rate

X 100 = 103 %

4458 [numri i çështjeve të reja për 2024]

Për çështjet e natyrës **penale themeli**, *Clearance rate*, norma e përfundimit/likuidimit të çështjeve është 103 %.

$$\text{Clearance rate} = \frac{634 \text{ [numri i çështjeve të gjykuara]}}{605 \text{ [numri i çështjeve të reja për 2024]}} \times 100 = 105 \%$$

Për çështjet e natyrës **penale kërkesa**, *Clearance rate*, norma e përfundimit/likuidimit të çështjeve është 105%.

$$\text{Clearance rate} = \frac{2177 \text{ [numri i çështjeve të gjykuara]}}{2170 \text{ [numri i çështjeve të reja për 2024]}} \times 100 = 100.32 \%$$

Për çështjet e natyrës **civile themeli**, *Clearance rate*, norma e përfundimit/likuidimit të çështjeve është 100.32 %

$$\text{Clearance rate} = \frac{1157 \text{ [numri i çështjeve të gjykuara]}}{1094 \text{ [numri i çështjeve të reja për 2024]}} \times 100 = 105 \%$$

Për çështjet e natyrës **civile kërkesa**, *Clearance rate*, norma e përfundimit/likuidimit të çështjeve është 105%.

$$\text{Clearance rate} = \frac{643 \text{ [numri i çështjeve të gjykuara]}}{589 \text{ [numri i çështjeve të reja për 2024]}} \times 100 = 109 \%$$

II. Koha e nevojshme për përfundimin/likuidimin e çështjeve (*case disposition time*) është treguesi që krahason numrin total të çështjeve të pazgjidhura, në fund të periudhës së caktuar, me numrin e çështjeve të zgjidhura, brenda të njëjtës periudhë kohore, raport ky i konvertuar në numër ditësh. Treguesi mat se sa shpejt sistemi gjyqësor i gjykatës punon mbi çështjet e marra që nënkupton kohën që duhet për përfundimin e çështjeve të caktuara në gjykatë, në dritën e ritmit të punës në atë gjykatë.

Koha e nevojshme për përfundimin/likuidimin e çështjeve (*case disposition time*) për çështjet e natyrës **penale themeli** është 108 ditë.

188 [numri i çështjeve në pritje për gjykim në

DT Penale 2024 $\frac{\text{datën } 31.12.2024]}{634 \text{ [numri i çështjeve të zgjidhura në vitin 2024]}} \times 365 = 108 \text{ ditë}$

Koha e nevojshme për përfundimin/likuidimin e çështjeve (*case disposition time*) për çështjet e natyrës penale **Kërkesa është 107 ditë.**

DT Penale 2024 $\frac{641 \text{ [numri i çështjeve në pritje për gjykim në datë 31.12.2023]}}{2177 \text{ [numri i çështjeve të zgjidhura në vitin 2024]}} \times 365 = 107 \text{ ditë}$

Koha e nevojshme për përfundimin/likuidimin e çështjeve (*case disposition time*) për çështjet e natyrës civile **themeli është 317 ditë.**

DT Civile 2024 $\frac{1008 \text{ [numri i çështjeve në pritje për gjykim në datë 31.12.2024]}}{1157 \text{ [numri i çështjeve të zgjidhura në vitin 2024]}} \times 365 = 317 \text{ ditë}$

Koha e nevojshme për përfundimin/likuidimin e çështjeve (*case disposition time*) për çështjet e natyrës civile **Kërkesa⁵ është 99 ditë.**

DT Civile 2024 $\frac{176 \text{ [numri i çështjeve në pritje për gjykim në datën 31.12.2024]}}{643 \text{ [numri i çështjeve të zgjidhura në vitin 2024]}} \times 365 = 99 \text{ ditë}$

Bazuar në një llogaritje mesatare të ngarkesës për gjyqtar, duke pjestuar numrin total të çështjeve të regjistruara në vitin 2024 me numrin e gjyqtarëve të gjykatës, rezulton një numër mesatar prej **342** të çështjeve të shqyrtuara për gjyqtar. Ky tregues nxjerr në pah ngarkesën në punë për gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë.

Raporti mbi numrin i çështjeve për çdo gjyqtar (*Case for Judge*), llogaritur duke pjestuar numrin total të çështjeve të regjistruara në vitin 2024 me numrin e anëtarëve të gjykatës;

$\frac{4458 \text{ [totali i numrit të çështjeve të regjistruara]}}{13 \text{ [numri i anëtarëve të gjykatës në vitin 2024]}} = 342 \text{ Numri i çështjeve për gjyqtar}$

Ngarkesa e lartë e gjyqtarëve ka ndikuar në afatin e arsyetimit të vendimeve gjyqësore, por përgjithësisht janë respektuar afatet ligjore të arsyetimit të vendimeve.

5. LLOJI I ÇËSHTJEVE DHE DËNIMEVE TË APLIKUARA

Çështje penale me të mitur

Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë është krijuar dhe vazhdon të funksionojë seksioni penal për gjykimin e çështjeve penale me të mitur që prej vitit 2009, bazuar në Dekretin nr.6218 datë 07.07.2009 të Presidentit të Republikës “Për krijimin e seksioneve penale për gjykimin e të miturve pranë gjykatave të rretheve gjyqësore“, me kompetencë tokësore në rrethet gjyqësore Korçë dhe Pogradec.

Ky seksion ka gjykuar çështjet penale me të pandehur të mitur sipas kompetencës tokësore të përcaktuar në dekretin e sipërcituar, kurse me hyrjen në fuqi të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur (datë 01.01.2018) ka gjykuar çështjet penale me të mitur në konflikt me ligjin si dhe çështjet ku të miturit janë viktima të veprave penale, sikurse përcaktohet në këtë Kod.

Në mbështetje të nenit 28§2 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur të miratuar me Ligjin nr.37/2017, në zbatim të Udhëzimit nr.79 datë 30.05.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, me vendimin nr. 23 Prot, datë 16.09.2024, të Këshillit të Gjykatës “Mbi ndryshimin e vendimit nr. 137 Prot, datë 25.10.2023 mbi shpërndarjen e gjyqtarëve në seksione dhe trupa gjykues”, me transferimin e gjyqtareve Ervin Sulaj dhe Sonjela Voskopi, pjesë e seksionit penal për të mitur janë gjyqtarët Luljeta Kolonja, Klajdi Tërova dhe Estjon Venxha.

Gjatë vitit 2024 në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë janë gjykuar 22 çështje penale me të mitur.

Tabela.4

Të dënuar të mitur Nr i çështjeve	Neni
1	89 K.Penal
1	283 K.Penal
2	121/A/3 K.Penal
3	100/1, 323/1 K.Penal
2	134/2, 129 K.Penal
5	130/a K.Penal

2	290/2 K.Penal
2	100/2 K.Penal
2	291 K.Penal
1	88/1 -25 K.Penal
1	273 K.Penal

Të dhënat e mësipërme paraqesim një rritje të numrit të gjykimeve me kategorinë e çështjeve penale me të mitur. Vihet re një rritje e numrit të çështjeve penale me mitur krahasur me vitin 2023.

Konkretisht gjatë vitit 2024 janë gjykuar 22 çështje penale me të pandehur të mitur. Veprat më të përhapura të gjykuara nga të miturit janë: Plagosje e lehtë me dashje, Prodhim dhe shitje e narkotikëve, Përndjekje, Dhunë në familje, Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur etj. Çështjet e gjykuara përgjatë vitit 2024 paraqesin rrezikshmëri më të lartë se gjykimet që i përkasin vitit 2023, ku rrezikshmëria e veprave penale ishte më e ulët.

Cështje penale themeli

Gjatë vitit 2024, gjykata ka gjykuar 634 çështje gjyqësore penale, ku rezulton se 37 çështje penale janë gjykuar me trup gjykues të përbërë me tre gjyqtarë dhe 597 çështje janë gjykuar nga një gjyqtar.

Duke filluar nga muaji Gusht 2017 e në vazhdim rezulton një rënie e numrit të çështjeve të gjykuara me trup gjykues të përbërë me tre gjyqtarë, për shkak të ndryshimit në nenin 13 të K.Pr.Penale, që lidhet me rritjen e maksimumit të dënimit penal nga 7 vjet në 10 vjet, për çështjet që gjykohen me tre gjyqtarë.

Tabela.5

Natyra e çështjeve	Numri i çështjeve për vitin 2024	Numri i çështjeve per vitin 2023
Penale themeli	634	617
Kërkesa gjatë hetimeve paraprake, kërkesa të veçanta penale, kërkesa në fazën e ekzekutimit etj	2177	2085

Veprat penale më të përhapura gjatë vitit 2024 janë “Vjedhja”, “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt” pa leje drejtimi ose në gjendje të dehur, “Dhuna në familje”, “Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve”, “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve” dhe “Kalim i paligjshëm i kufirit shtetëror” etj.

Nisur nga të dhënat e mësipërme rezulton se kriminaliteti në Qarkun e Korçës kryesisht karakterizohet nga veprat penale me rrezikshmëri të ulët shoqërore, ndërsa rastet e veprave penale me rrezikshmëri të lartë shoqërore dhe shumë të lartë shoqërore janë më të pakta.

Si shkaqe të kryerjes së këtyre veprave janë një sërë faktorësh duke filluar që nga gjendja e vështirë ekonomike dhe familjare, papunësia, niveli i ulët arsimor etj.

Llojet e dënimeve të dhëna nga gjykata

Tabela.6

Dënimi	Numri i çështjeve gjyqësore
Me gjobë	32
Burgim deri në dy vjet	140
Burgim nga 2 deri ne 5 vjet	71
Burgim nga 5 deri ne 10 vjet	17
Burgim nga 10 deri ne 25 vjet	9
Burgim i përhjetshëm	1
Burgim nga 25 deri ne 35 vjet	0
Totali	270

Gjatë vitit 2024 rezulton të jetë dhënë një vendim dënimi me burgim të përhjetshëm. Dënimi më i aplikuar nga gjykata është dënimi me burgim deri në dy vjet dhe dënimi me gjobë çka referuar të dhënave statistikore për figurat e veprave penale, përputhet me rrezikshmërinë e ulët të veprës penale. Në raste më të pakta është dhenë pafajësi dhe është aplikuar neni 59 apo 63.

Përgjatë vitit 2024, është aplikuar neni 63 në 20 raste, neni 59 në 239 raste, dhe është dhënë pafajësi në 13 raste. Gjykata ka vendosur pushimin e çështjes penale në 71 raste. Në 21 raste të tjera ka vendosur refuzim urdhëri penal, miratim urdhëri penal etj.

Analiza për çështjet me objekt Lirim me kusht dhe aplikimi i nenit 59

Zbatimi i dënimeve alternative është një mundësi që u jepet personave në konflikt me ligjin për tu riintegruar në shoqëri si qytetarë për të jetuar një jetë të denjë.

Aplikimi i kësaj dispozite është kërkesë e kohës por edhe e standarteve ndërkombëtare siç shprehet edhe Këshilli i Europës *“Burgimi duhet të zbatohet si masë vetëm kur çdo masë apo sanksion tjetër do të ishin të papërshtatshme për rëndësinë e veprës dhe duhet të bëhen përpjekje që të minimizohet përdorimi i masave që privojnë personin nga liria dhe të zbatohen më shumë ato të cilat nuk e bëjnë këtë”*.

Lirimi me kusht, nënkupton lirimin e parakohshëm të të dënuarit me burgim në kushte të përcaktuara për periudhën e paslirimit. Lirimi me kusht është përdorur në përshtatje me rrethanat individuale dhe në përputhje me parimet e ligjit dhe të drejtësisë. Lirimi me kusht ka ardhur në ndihmën e të dënuarit për të bërë tranzicionin nga jeta e burgut në atë të një qytetari që i bindet ligjit në komunitet, përmes kushteve të supervizimit pas lirimit që kontribuojnë në sigurinë publike dhe në reduktimin e krimit në komunitet. Gjykata ka vendosur një ose më shumë detyrime, mbi bazën e rrezikshmërisë të pakët shoqërore, moshës, qenia kryefamiljar, fakti që personat nuk kanë precedentë penalë dhe nuk rezultojnë me personalitet negativ, qëndrimi në fazën e hetimeve paraprake duke dhënë shpjegime lidhur me rrethanat dhe pranimin në gjykim të akuzës, duke shprehur pendim të thellë për veprën penale të kryer etj.

Zbatimi i dënimeve alternative është një mundësi që u jepet personave në konflikt me ligjin për tu riintegruar në shoqëri si qytetarë për të jetuar një jetë të denjë. Përgjatë vitit 2024 janë gjykuar 51 kërkesa për lirim me kusht, nga të cilat gjykata ka disponuar me pranim vetëm në 6 raste dhe në 45 raste ka vendosur deklarin e papranueshëm të kërkesës.

Neni 63

Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe detyrimi për kryerjen e një pune në interes publik

Puna me interes publik nënkupton kryerjen nga i dënuari të një pune, me pëlqimin e tij dhe pa shpërblim, në favor të interesit publik apo shoqatës së caktuar në vendimin e gjykatës, për një kohë nga dyzet deri në dyqind e dyzet orë.

Neni 63 i Kodit Penal parashikon edhe mënyrën e vuajtjes së këtij dënimi, duke mbajtur parasysh detyrimet familjare të të dënuarit; interesat dhe aftësitë e tij, etj. Në çdo rast koha ditore e punës nuk mund t'i kalojë 8 orë në ditë.

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë ka aplikuar dispozitën e nenit 63 *“Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe detyrimi për kryerjen e një pune në interes publik”* në 20 raste duke marrë parasysh rrethanat në të cilat ka ndodhur vepra, të cilat janë të tilla që e justifikojnë aplikimin e alternativës së dënimit, si gjendja e vështirë ekonomike e cila kërkonte domosdoshmërinë e të pandehurit të lirë, qenia e fëmijëve të mitur që kërkon prezencën e bashkëshortit në familje etj.

Tabela.7

Lloji i dënimit	Numri
Punë me interes publik (neni 63 i K.Penal)	20 çështje
Pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënia në provë (Neni 59 i K.Penal)	239
Gjysmëliria (Neni 58 i K.Penal)	0

Kërkesat penale

Gjatë vitit 2024 janë gjykuar 2177 çështje të natyrës kërkesa penale dhe kërkesa penale-administrative, ku përfshihen kërkesat në fazën e hetimeve paraprake si vleftësim arresti dhe caktim mase sigurimi personal, lejim përgjimi, kërkesa në fazën e ekzekutimit të dënimit, si ulje dënimi, lirim para kohe me kusht nga vuajtja e dënimit, aplikim të dënimeve alternative, kërkesa për marrëdhëniet juridiksionale me jashtë si kërkesa për njohje të vendimeve të gjykatave të huaja, kërkesa për ekstradim etj.

Gjatë vitit 2024 janë gjykuar 478 çështje të natyrës kërkesa penale me objekt vleftësim arresti dhe caktim mase sigurimi personal për të cilat është vendosur:

Tabela.8

Lloji i masës sigurimit	Numri
Arrest në burg	204
Arrest në shtëpi	55
Detyrim për paraqitje	168
Garanci pasurore	9
Caktim mase (me karakter sekret)	34
Deklarim ikje	3
Rivlerësim mase sigurimi	0
Shtrim i përkohshëm në spital psikiatrik	5

Nga treguesit e mësipërm rezulton se masat e sigurimit më të aplikuara nga gjykata janë ato “arrest në burg” dhe “detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore”.

6. KËRKESAT PËR HEQJE DORË/ PËRJASHTIM NGA ÇËSHTJET

Tabela.9

Kërkesat për heqje dorë të miratuara nga zv.kryetari	Viti 2024
Pranim	52
totali	52

Shkaqet kryesore të heqjes dorë nga gjykimi i çështjeve për vitin 2024 lidhen me pjesëmarrjen e gjyqtarëve në procese të tjera gjyqësore të lidhura apo vendimarrje të mëparshme ku kanë shfaqur mendim në lidhje me objektin e çështjes, apo rastet kur gjyqtari ka dhënë vendim dënimi për të bashkëpandehurin në të njëjtin procedim. Në disa raste kërkesa për heqje dorë është pranuar pasi gjyqtari përmes vendimarrjes ka shfaqur mendim mbi objektin e mosmarrëveshjes, ose ka shfaqur mendim në lidhje me çështjen objekt gjykimi dhe qënien para arsyeve serioze të dukjes së njëanshmërisë.

NUMRI I KËRKESAVE PËR PËRJASHTIM GJYQTARI NGA GJYKIMI I ÇËSHTJEVE

Çështjet civile:

Tabela.10

Kërkesat për përjashtim gjyqtari	Viti 2024
Deklarim papranueshmërie	2
Pranuar	1
Pushuar	1
Mospranim	0
Rrëzuar	8
Total	12

Çështjet penale:

Tabela.11

Kërkesat për përjashtim gjyqtari	Viti 2024
Deklarim papranueshmërie	9
Pranuar	0
Pushuar	0
Mospranim	2
Rrëzuar	5
Total	16

Përgjatë vitit 2024 janë depozituar pranë gjykatës 28 kërkesa për përjashtim gjyqtari. Nga analiza e rasteve të shqyrtimit të kërkesave për përjashtimin e gjyqtarëve vërehet se rezultojnë vetëm një kërkesë e pranuar, shkaku kryesor i pranimi të saj është garantimi edhe në dukje i paanshmërisë së gjyqtarit. Ndërsa shkaktohet kryesore të rrëzimit të kërkesës për përjashtim janë: paraqitja nga pala kërkuese si shkak përjashtimi vendimarrja e ndërmjetme e gjyqtarit, mosparaqitja e arsyeve të njëanshmërisë nga ato të parashikuara në ligj, dhe mosdepozitimi i akteve për të provuar ekzistencën e arsyeve të njëanshmërisë.

7. DELEGIMET E GJYQTARËVE

Gjatë vitit 2024, gjyqtarët e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë janë deleguar për të gjykuar çështje për llogari të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

- Gjyqtare Eglantina Mikani 2 çështje penale,
- Gjyqtare Luljeta Kole 3 çështje penale,
- Gjyqtar Artan Jahollari 1 çështje penale,

Tabela.12

Delegimet sipas natyrës së çështjes	Viti 2024
Penale	6
Kërkesa penale	0
Civile	0
Total	6

8. ORGANIZIMI DHE MENAXHIMI I VEPRIMTARISË ADMINISTRATIVE TË INSTITUCIONIT

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë ka qenë gjithnjë promotore e instalimit dhe funksionimit të sistemit të regjistrimit audio që në fillimet e saj duke i njohur vlerat dhe potencialin e rritjes së transparencës që garanton kjo teknologji.

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë në zbatim të akteve nënligjore zhvillon gjykimet vetëm në sallat e gjykimit dhe me sistemin e regjistrimit audio. Pas ndryshimeve në Kodin e Procedurës Civile dhe Kodin e Procedurës Penale një pjesë e gjykimeve sipas këtyre ndryshimeve zhvillohen nga gjykata në dhomë këshillimi. Për këtë arsye ato nuk mund të regjistrohen në sistemin audio.

Regjistrimi audio nuk realizohet në 100% të gjykimeve, vetëm për pjesën kur kjo Gjykatë shqyrton çështje në dhomë këshillimi. Të gjitha çështjet e tjera të cilat gjykohen në seancë gjyqësore regjistrohen në sistemin audio. Nuk ka asnjë gjykim të zhvilluar në zyrat e gjyqtarëve apo në mënyrë tjetër të regjistrimit të procesverbalit veç regjistrimit audio.

Veprimtaria administrative dhe menaxhuese e titullarit të gjykatës vazhdon të jetë e dokumentuar në formë shkresore, duke lënë gjurmë në vendimmarrje dhe duke krijuar një praktikë të konsoliduar.

Gjykimet e planifikuara fillojnë në orarin e caktuar sipas listave të shpallura për gjykim. Trupa gjyqësore ka qenë e impenjuar për përfundimin e gjykimit të çështjeve me shpejtësi dhe cilësi. Vonesat për fillimin e gjykimeve janë të vogla. Rastet kur hasemi me to kanë të bëjnë kryesisht me vonesën e avokatëve, apo zgjatjen e seancave gjyqësore pararendëse tej orarit të planifikuar.

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë si një institucion publik, dedikuar dhënies së drejtësisë, udhëhiqet nga fryma për të ofruar një shërbim cilësor në interes të qytetarit, në zbatim të kërkesave parimore dhe përgjegjësisë ligjore, në respektim të parimit ndërkombëtar të drejtësisë, atij të një procesi të rregullt ligjor. Nëpërmjet veprimtarisë së saj, luan një rol të rëndësishëm në rritjen e besimit të publikut tek drejtësia, rritjen e integritetit moral e profesional të anëtarëve të sistemit gjyqësor, mbrojtjen e figurës së gjyqtarit dhe statusit të tij. Për këtë qëllim, i është dhënë prioritet faktit të hedhjes së shortit elektronik çdo ditë të javës, shorti është i monitorueshëm nga qytetarët nëpërmjet pikës së Info Point, të vendosur në ambientet e brendshme të gjykatës.

Janë konsoliduar në mënyrë të dukshme parametrat e një shërbimi cilësor, të shpejtë dhe transparent ndaj publikut dhe medias, duke qenë në kontakt periodik me këta faktorë dhe evituar çdo problematikë të dalë. Theksojmë se në këtë gjykatë prej kohësh publikut i ofrohen shërbime cilësore në çdo kohë, gjatë gjithë orarit zyrtar.

- Është konsoliduar rritja e transparencës së vendimmarrjes gjyqësore duke i krijuar mundësinë palëve dhe publikut, jo vetëm nëpërmjet pjesëmarrjes në seancat gjyqësore publike dhe marrjen e kopjeve të regjistrimeve audio, por edhe nëpërmjet aksesit të mjaftueshëm për t'u informuar në lidhje me gjyqtarin e çështjes menjëherë pas hedhjes së shortit, apo për datën dhe orën e gjykimit, menjëherë pas vënies në lëvizje të çështjes nga ana e gjyqtarit. Kjo është bërë e mundur nëpërmjet vendosjes së monitorëve në të cilët jepen në mënyrë elektronike të dhënat për këtë qëllim.
- Është konsoliduar mënyra e hedhjes së çështjeve në short, ku çdo çështje i është nënshtruar vetëm shortit elektronik të implementuar zyrtarisht në gjykatë, duke përfshirë dhe formimin e tresheve jo standarte të përcaktuar me urdhër të brendshëm të titullarit.
- Janë përmirësuar parametrat bazë të një gjykimi, si ato cilësore, dhe të një gjykimi në një afat sa më të arsyeshëm, standarte këto të një gjykimi bashkëkohor. Pavarësisht vështirësive të shkaktuara nga numri i lartë i çështjeve për gjyqtar është realizuar në kohë arsyetimi dhe dorëzimi i vendimeve gjyqësore.
- Është treguar vëmendje e veçantë për marrëdhëniet institucionale përfshirë këtu bashkëpunimin institucional me Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, Drejtorinë Vendore të Policisë Korçë, Drejtorinë Rajonale të Kufirit dhe Migracionit, Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Korçë, Shërbimin e Provës Dega Territoriale Korçë, Drejtoritë Rajonale Vendore, si dhe me Organet e Njësive të Qeverisjes Vendore, marrëdhënie të cilat kanë funksionuar normalisht.
- Meqënëse shërbimi postar vazhdon të paraqesë ende mangësi të theksuara është kërkuar vazhdimisht plotësimi i rregullt i akt-njoftimeve duke mbajtur takime periodike institucionale.
- Është treguar kujdes duke u garantuar orari i fillimit të gjykimeve si dhe solemniteti i gjykimeve, duke u zhvilluar të gjitha gjykimet nëpër sallat e gjykimeve, fakt i dokumentuar nga vulat kohore të sistemit audio rekorder si dhe është bërë planifikimi i të gjitha gjykimeve në kalendarin elektronik.
- Janë verifikuar rregullisht ankesat e palëve dhe të interesuarve, duke iu përgjigjur zyrtarisht shqetësimeve të paraqitura, si dhe duke dokumentuar çdo ankesë të depozituar.
- Nëpërmjet urdhërit të zv/kryetarit i cili ushtron detyrën e kryetarit janë planifikuar me periudha katër mujore, bazuar në rendin alfabetik me bazë mbiemrin, gjyqtarët që do shqyrtojnë kërkesat e Prokurorisë për masat e sigurimit dhe të tjera kërkesa në fazën e hetimeve paraprake, duke u kujdesur edhe për sekretin e hetimit. Po kështu është nxjerrë urdhëri mbi gadishmërinë e gjyqtarëve të seksionit penal për gjykimin e të miturve, për periudha katër mujore.

- Janë punuar të gjitha materialet e ardhura nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, Ministria e Drejtësisë, apo institucione të tjera dhe që kanë pasur lidhje të drejtpërdrejtë me punën, si dhe është bërë njohja e gjyqtarëve dhe administratës me vendime apo rregullore të dala në funksion të veprimtarisë gjyqësore.
- Janë mbajtur takime të rregullta dhe periodike me administratën gjyqësore, në kujdesin dhe të kancelarit është kryer rakordimi nëpërmjet sektorëve duke dëgjuar si dhe zgjidhur problemet që punonjësit kanë pasur, në funksion të një ecurie sa më të mirë të punës së përditshme.
- Ka vazhduar kujdesi i veçantë në lidhje me vendin e pritjes së publikut si dhe ambienteve, holleve dhe sallave të gjykimit, duke përmbyllur misionin dhe qëllimin e një organi tërësisht në funksion të qytetarëve, në lidhje me respektimin e rendit dhe sigurisë në ambientet e gjykatës.
- Ka funksionuar rregullisht duke u pasuruar në vijimësi Këndi i Publikimeve, në të cilën gjejnë pasqyrim të gjitha afishimet e ndryshme, të gjyqtarëve, si shpallje, lista gjykimesh, listat ditore të shortit, rregullore, urdhërat e titullarit etj, duke qenë në çdo kohë plotësisht e aksesueshme për publikun.
- Ka vazhduar rregullisht bashkëpunimi me Drejtorinë e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor i cili është organi që merret me zbatimin e politikave buxhetore në Pushtetin Gjyqësor, duke bërë një rishpërndarje transparente, të drejtë dhe tepër efektive të fondeve vjetore të akorduara gjykatës, të cilat falë mirëadministrimit, kanë qenë të mjaftueshme për mbarëvajtjen e punës.

9. PROBLEMATIKA DHE VËSHTIRËSI TË HASURA GJATË PUNËS

Konstatohet se ka një numër të konsiderueshëm çështjesh të cilat janë mbartur për vitin në vazhdim. Pjesa më e madhe e tyre janë çështje të pezulluara, për të cilat pritet të bjerë shkak i pezullimit në mënyrë që të vazhdojë gjykimi, kurse për pjesën tjetër, gjykimet janë zvarritur për shkaqe të ndryshme procedurale. Nga konstatimi i hollësishëm i shkaqeve të pezullimit, rezulton se çështjet janë pezulluar kryesisht për shkaqe të fillimit të një çështje tjetër civile ose penale dhe më pak administrative, që ka lidhje me çështjen e pezulluar, që ndodhen për shqyrtim në këtë gjykatë, në Gjykatën e Apelit, ose në Gjykatën e Lartë si dhe për hetim në Prokurorinë e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë. Në të gjitha këto raste është duke u pritur përfundimi i gjykimit të këtyre çështjeve, pra i rënies së shkakut të pezullimit, për të bërë të mundur vazhdimin e gjykimit. Vlen për t'u përmendur se gjyqtarët e këtyre çështjeve në mënyrë periodike kanë kryer verifikime për rënien e shkakut të pezullimit.

Po kështu, një pjesë e madhe e këtyre çështjeve janë mbartur artificialisht, për vitin 2024 për shkak të hedhjes në short elektronik pothuaj deri në ditët e fundit të vitit, duke mos i lënë të depozitohen pa iu nënshtruar shortit.

Megjithë arritjet e analizuara duhet të nënvizojmë dhe faktin që në punën e përditshme, edhe për këtë vit gjyqësor, si çdo vit tjetër gjyqësor, jemi ndeshur me disa vështirësi të karakterit objektiv si: shtyrjet e gjykimeve, problematika e një sistemi të rregullt adresash dhe njoftimi nëpërmjet shërbimit postar, problematika e mbajtjes dhe ruajtjes së fondit arkivor.

Shtyrja e seancave gjyqësore, ku disa prej shkaqeve janë: Paraqitja e raporteve mjekësore, nga ana e të pandehurve, palëve apo e mbrojtësve të tyre, duke u bërë shkak për abuzime në këtë drejtim; Kërkesa për shtyrje të mbrojtësve, duke përdorur arsye familjare apo gjykime të tjera; Mospasja dijeni e palëve për ditën dhe orën e gjykimit, për shkak se njoftimet nuk kanë arritur në afat si rezultat i zonave të largëta dhe vështirësive të komunikimit postar, apo kur njoftimi i kryer përmban elemente pavlefshmërie;

Problematika e sistemit të adresave dhe e shërbimit postar, ka të bëjë me mungesën e një sistemi të rregullt adresash, apo kur pala, e cila inicion gjyqin, nuk vë në mënyrë korrekte adresat e sakta të të paditurve, çka çon në njoftime të pakonfirmuara dhe si rrjedhim në shtyrjen e seancave gjyqësore. Problem paraqet edhe moskthimi i fletë-thirrjeve në afatin e caktuar ose kthimi i komunikimeve por që përmbajnë elemente pavlefshmërie, për shkak edhe të mungesës së profesionalizmit të postierëve. Një gjë e tillë ka sjellë si pasojë jo vetëm shtyrjen e gjykimeve, por dhe rritjen e shpenzimeve pasi tarifat janë paguar për çdo rast.

Duke parë problematikën e parashtruar më sipër janë bërë përpjekje maksimale, për të trajtuar rastet e tilla. Iu është kërkuar në vijimësi gjyqtarëve që të bëjnë prezent këto raste, me qëllim marrjen e masave, duke vënë në dijeni për çdo rast drejtuesin e postës. Po kështu kanë qenë të shumta rastet që komunikimet janë bërë nëpërmjet ftuesve të gjykatës, duke iu vënë në dispozicion automjetet e këtij institucioni. Është mbuluar edhe këtë vit, me këtë formë njoftimi pothuaj gjithë zona periferike si dhe zonat e largëta ku ka vonesa të kthimit të konfirmimit të fletëthirrjes.

Me ndryshimet e reja në legjislacionin procedural penal e civil, është rritur ndjeshëm numri i njoftimeve, si atyre për datën dhe orën e gjykimit, ashtu edhe veprimet paraprake të gjyqtarit apo të vendimeve që jepen në përfundim të gjykimit. Ndërkohë që pavarësisht këtij fluksi të rritur janë bërë përpjekje maksimale për të përballuar ngarkesën me qëllim kryerjen në kohë dhe brenda një afati sa më të shkurtër të këtyre njoftimeve, çka lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me cilësinë e gjykimeve dhe afatin e përfundimit të tyre.

Shtimi i kërkesave për informacion drejtuar gjykatës nga ana e gazetarëve apo aktorëve të tjerë të shoqërisë civile, kërkesa këto me objekt studimor, të cilat kërkojnë burime njerëzore për realizimin e tyre. Pozicioni i Koordinatorit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale mbulohet në gjykatë nga Specialistit përkatës i cili në bashkëpunim me kancelarin dhe gjyqtarin e medias, janë përgjigjur në kohë dhe në përputhje me përcaktimet e Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

10. PRIORITETET PËR VITIN 2025

Ndër prioritet e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë për vitin 2025 mbeten ndër të tjera:

- Rritja e standartit të cilësisë së gjykimeve si një nga prioritetet kryesore të gjykatës
- Rritja e mëtejshme e parametrave bazë të një gjykimi si: cilësia dhe gjykimi brenda një afati të arsyeshëm, në funksion të parimeve një drejtësi pa vonesa, si dhe respektimit të procesit të rregullt ligjor, etika, solemniteti, profesionalizmi, transparenca, efikasiteti, si dhe cilësia e shërbimeve ndaj palëve, publikut dhe medias, duke u përshtatur me standartet e një gjykimi bashkëkohor
- Gjykimi i çdo çështje brenda një afati të shkurtër kohor duke evituar në këtë mënyrë zvarritjen e proceseve gjyqësore
- Rritja e besimit të opinionit publik në sistemin e drejtësisë
- Mbrojtja e personalitetit, dinjitetit, pavarësisë, integritetit profesional dhe njerëzor dhe sigurisë profesionale gjatë gjithë kohës së ushtrimit të detyrës nga ana e gjyqtarëve duke marrë parasysh faktin që trupa gjyqësore po përballet çdo ditë me një numër të madh sfidash .
- Përmirësimi i mëtejshëm i veprimtarisë administrative të gjykatës. Në këtë kuadër shihet me rëndësi rritja e nivelit profesional të administratës së gjykatës, etikës në komunikim si me publikun ashtu edhe me trupën gjyqësore, përkushtimi i tyre në punë, kryerja e detyrave me korrektësi dhe shpejtësi.
- Forcimi i bashkëpunimit veçanërisht me Dhomën e Avokatisë Korçë në mënyrë që numri i seancave gjyqësore si pasojë e mungesës së avokatëve të jetë sa më i vogël.
- Bashkëpunim me gjykatat e tjera të juridiksionit të përgjithshëm, duke vendosur ura të ngushta bashkëpunimi dhe shkëmbyer eksperiencat më të mira.
- Vazhdimësia e implementimit në gjykatë i projekteve të cilat synojnë dhe garantojnë rritjen e transparencës dhe performancës së institucionit duke e shndëruar Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë në një organ tërësisht shërbimi, në dispozicion të të gjithë komunitetit.
- Ofrimi i shërbimeve për publikun me shpejtësi, korrektësi dhe duke respektuar të drejtat e palëve në gjykim.
- Trajnimi i mëtejshëm i administratës së gjykatës për aspekte të ndryshme të veprimtarisë, gjë e cila do të çonte në përmirësim të dukshëm të cilësisë së shërbimeve që ofrohen nga kjo administratë.

- Kontakt më i drejtpërdrejtë dhe i shpeshtë me median nëpërmjet dhënies së informacioneve dhe deklaratave për shtyp që kanë të bëjnë si me veprimtarinë e gjykatës në tërësi ashtu dhe me çështje të veçanta për të cilat opinioni publik mund të ketë interes.

Në përfundim të kësaj analize, si prioritet do të jetë angazhimi i gjyqtarëve dhe sektorëve për të pasur si objektiv kryesor të punës së tyre në vitin 2025 zbatimin e ligjit, dhënien e drejtësisë në përputhje me legjislacionin në fuqi, me shpejtësi dhe transparencë në mënyrë që drejtësia jo vetëm të bëhet por edhe të duket duke siguruar standartin më të lartë në garantimin e lirive dhe të drejtave të qytetarëve.

ZV.KRYETARE E GJYKATËS
EGLANTINA MIKANI